



REPUBLIKA E KOSOVËS - REPUBLIKA KOSOVO	
KOMUNA E VUSHTRRISË-OPŠTINA VUČITRN	
01 Nr. / Br	177/13
Nr. i fq. / Br. st	-4-
Data: / Datum	25.07.2013
VUSHTRRI - VUČITRN	



REPUBLIKA E KOSOVËS

KUVENDI I KOMUNËS-VUSHTRRI

PROCESVERBAL

Nga mbledhja e jashtëzakonshme (VI-të për vitin 2013), e
Kuvendit Komunal në Vushtrri, mbajtur më 11.06.2013

Mbledhja është mbajtur në sallën e kuvendit komunal duke filluar në orën 15:15. Në këtë mbledhje ishin të pranishëm anëtarët e Kuvendit të Komunës në Vushtrri: Arta Ismajli, Avdullah Halimi, Bahrije Pllana, Besim Jashari, Ergin Sunguri, Esat Beka, Ferit Idrizi, Gani Imeri, Gjylsime Feka, Habib Mustafa, Habibe Gérxhaliu, Hajrulla Muli, Islam Krasniqi, Ismet Gashi, Naile Osmani, Makfirete Ademi, Merjeme Ismajli, Melihate Basholli, Muhamrem Shabani, Nysret Gérxhaliu, Pajazit Pllana, Qazim Azemi, Refik Ramaj, Remzije Isufi, Sabit Kadriu, Sabri Ferati, Selim Rrustemi, Selvete Sholla, Shpëtim Zhegrova, Syzana Syla, Tasim Gubetini, Veli Karaça, Vlora Qirezi, Xhemajl Pllana dhe Zeqir Hasani.

Munguan: Ferit Idrizi dhe Gani Imeri, anëtarë të kuvendit.

Të pranishëm në këtë mbledhje ishin edhe kryetari i komunës, drejtorët e drejtive komunale, përfaqësuesi i OSBE-së dhe përfaqësues të mediave të shkruara dhe të shoqërisë civile.

Mbledhjen e hapi dhe e kryesoi Habib Mustafa - kryesues i kuvendit, i cili pasi konstatoi se ka kuorum për punë, propozoi këtë:

RENDITE

1. Shqyrtimi i rishikimit të buxhetit për vitin 2013.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së paraqiti sqarime hyrëse lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2013.

Shpëtim Zhegrova, anëtar i kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të PDK-së kërkoi që prej mjeteve tek rrugët me kubëza të hiqen 25.000 € dhe të ridesthohen për vazhdimin e rrugës në fshatin Sfaraçak dhe në fshatin Studime, si dhe prej të njëjtit fond të hiqen 6.500 € për ndërtimin e urës në fshatin Pantinë.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit - në emër të Grupit kuvendar të LDK-së shprehu brengosje që një çështje kaq e rëndësishme me qenë me kaq urgjencë edhe pse në bazë të sqarimeve të drejtorit, shihet se nuk është faji i komunës, por është i Ministrisë së Financave. Në vazhdim lidhur me Zyrën e kuvendit të komunës, pyeti se cila është arsyja që nga kjo zyrë kanë tepruar 18.569 €. Mandej lidhur me

rekomandimin e KPF-së pér rregullimin e rrugëve me kubëza betoni të ridestinohet në shkollën e Maxhunajt dhe të Pestovës, por nuk janë cekur shumat, prandaj është e nevojshme të ceken shumat. Kurse lidhur me projektin "ndriçimet publike" që do të barten mjetet, tha se duhet të ceket pér cilat rrugë bëhet fjalë, dhe të njëjtin specifikim e kërkoi edhe pér shumën mbi 12.000 €, projektin "pajisje pér sistemin e kanalizimit dhe ujësjellësit", fondi pér bashkëfinancim të rrugëve në kubëza dhe trotuare, duke shtuar se vërejtja e Grupit kuvendar të LDK-së (e cila ka qenë edhe arsyaja pse nuk është votuar buxheti) ka qenë fondi pér bashkëfinancim të rrugëve në kubëza dhe trotuare, pasi që ka qenë i agreguar dhe nuk ka qenë i deshifruar dhe prapë e njëjta po bartet. Prandaj në emër të LDK-së kërkoi që të emërtohen se pér cilat rrugë bëhet fjalë, duke kërkuar transparencë të plotë pasi që kuvendi i komunës ka aprovuar edhe Rregulloren pér Transparencë.

Zeqir Hasani, anëtar i kuvendit- tha se nuk janë përfshirë të gjitha rekondimet e dala nga KPF-ja, pasi që mungon rekondimi pér rregullimin e rrugës (në gjatësi prej 300 metrave) në fshatin Sfaraçak te familja "Ferati". Kurse lidhur me rishikimin e buxhetit pér vitin 2013, tha se është kundër bartjes së mjeteve kaq të mëdha në shuma pér rregullimin e kubëzave me beton, si dhe specifikimi i tyre dhe shtoi se këto mjete ka qenë më mirë të barten në disa projekte tjera, siç janë: rregullimi i rrugës në Sfaraçak, rregullimi i rrugës te varrezat (te "Rashicët"), pasi që ajo lagje është në gjendje të rëndë, prandaj propozoi që të barten 50.000 €, kurse pér rregullimin e rrugës në Sfaraçak të barten 20.000 €, po ashtu një pjesë e mjeteve të barten pér blerjen e kamerave pér çerdhen e fëmijëve. Ndërsa lidhur me tabelën e projekteve kapitale pér vitin 2013-2015 te ndërtimi i shkollave, tha se nuk dihet pér cilën shkollë bëhet fjalë në qytet e pér ndërtimin e së cilës janë 50.000 €, si dhe nuk specifikohet fare se pér cilat fshatra kategoria "ndërtimi i shkollave nëpër fshatra", prandaj ka mundësi që një pjesë e këtyre mjeteve pér vazhdimin e ndërtimit dhe finalizimit të shkollës në Pestovë dhe renovimin e shkollës në Maxhunaj, sepse shuma e mjeteve prej 45.000€ që është ndarë pér renovimin e shkollës në Smrekonicë, nuk figuron askund në projektet kapitale.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar rishikimit të buxhetit pér vitin 2013, paraqiti vërejtje që nga Drejtoria pér Arsim zbritet një shumë e caktuar e mjeteve, kur dihet se në vitin e kaluar është dashtë këtë njësi buxhetore ta ndihmojmë dhe shtoi se as buxheti që ka qenë i planifikuar nuk ka qenë i mjaftueshëm, prandaj nuk ka nevojë që të zbritet shuma nga Drejtoria pér Arsim, sepse na duhet ta ndihmojmë këtë drejtori, siç i kemi ndihmuar edhe vitin e kaluar. Pastaj tha se rruga në fshatin Brusnik ka mbetur në dy segmentet e papërfunduar, sepse inxhinierët kanë thënë se nuk mund të përfundohen këto segmente në mungesë të mjeteve financiare, kurse tash po zbriten mbi 4.000 € nga ato dy segmente, kjo duket anakronike, prandaj diçka nuk është në rregull tek shpërndarja e mjeteve nëpër zëra buxhetor.

Besim Jashari, anëtar i kuvendit- tha se rishikimi i buxhetit pér vitin 2013 është një çështje jashtëzakonisht e rëndësishme dhe shtoi se instruksioni i ardhur nga Ministria e Financave është një mundësi pér komunën, por kjo mundësi vlen pér ato komuna që kanë planifikuar mirë dhe kanë pasur ndonjë shmangje. Pastaj tha se kuvendi i komunës nuk guxon të bjerë pre e aspiratave politike, duke propozuar ndonjë projekt që nuk është i arsyeshëm, prandaj ekzekutivi i komunës është dashtë me qenë shumë i përgatitur pér t'u fokusuar në projektet prioritare, duke e pasur parasysh edhe afatin e mundësisë së realizimit deri në fund të vitit. Mandej lidhur me shumën e ndarë pér blerjen e inventarit pér objektin e ri të komunës, tha se dihen arsyet që ka dështuar finalizimi i objektit të ri të komunës, prandaj propozoi që t'i jepet prioritet ndriçimit përreth Palestrës së sporteve "Jeton Tërstena". Po ashtu propozoi që t'i jepet përparësi edhe rregullimit të kanalit të kullimit në rrugën e fshatit Maxhunaj, pasi që është një pjesë e rrugës ku flen uji dhe ka pasur aksidente, prandaj propozimin pér dhënier përparësi e paraqiti në mënyrë që të shmanget

aksidentet dhe të mos rrezikohen kalimtarët, si dhe propozoi që t'i jepet përparësi shtrimit të rrugës në lagjen e "Starasellëve" në fshatin Dumnicë e Llugës, me qëllim të stimulimit të zhvillimit të blegtorisë, sepse ka familje që janë zhvendosur nga qyteti në lagjen në fjalë, të cilët po dëshirojnë ta zhvillojnë blegtorianë.

Pajazit Pllana, anëtar i kuvendit- duke iu referuar rishikimit të buxhetit për vitin 2013, tha se pasi që shëndetësia në këtë periudhë është në gjendje të rëndë, nga lista esenciale e barërave që janë të nevojshme të sigurohen nga Ministria e Shëndetësisë përqindja ka rënë në mënyrë drastike, dhe shtoi se niveli primar duhet të ndihmohet në ato pjesë që janë vitale: emergjencia dhe pjesët tjera të terrenit, si dhe të sigurohet ujë në të gjitha ambulancat, në mënyrë që edhe pacientët të kenë qasje në atë ujë.

Muharrem Shabani, anëtar i kuvendit- tha se situata nuk ka qenë e jashtëzakonshme që të thirret mbledhja e KK-së brenda 24 orëve, prandaj është dashtë të thirret mbledhja konform Rregullores së Punës së Kuvendit. Pastaj lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2013, pyeti sesi mund të propozohet nga administrata e komunës projekte të cilat fare nuk kanë qenë të miratuarë në listën e projekteve për vitin 2013, si dhe nuk kanë qenë as në diskutim publik. Mandej tha se është obligim që çdoherë të jetë prezent zhvillimi harmonik i komunës me projekte, pa marrë parasysh përcaktimet partiake. Në vazhdim tha se është paraqitur një propozim qesharak e që është pajisja e bibliotekave me libra në vlerë prej 1.000 €, prandaj kërkoi që kjo shumë të pesëfishohet. Po ashtu përmendi çështjen e gypave të kanalizimit në fshatin Stanoc i Epërm, të cilët për më shumë se një vit janë në shkollë, dhe shtoi se mjetet e alokuara nga qytetarët rrinë në konto dhe akoma nuk ka zgjidhje për çështjen e kanalizimit. Gjithashtu tha se nëse është dhënë afati për ndërtimin e një shkolle, siç është shkolla në Pestovë, a është më mirë që kjo shkollë të kryhet brenda një viti shkollor, dhe të mos pritet kryerja e saj me projekt dyvjeçar. Në fund kërkoi që sa më shpejt të specifikohen se cilat rrugë po shtrohen me kubëza, asfalt dhe zhavorr, në mënyrë që gjithçka të shkojë me transparencë dhe konform ligjit.

Isuf Jashari, drejtor i DBF-së- duke iu referuar pyetjeve dhe vërejtjeve të anëtarëve të kuvendit, u përgjigj me sa vijon: në rastin e marrjes së Qarkores Buxhetore 02/2013, granti specifik i arsimit dhe i shëndetësisë i kanë mjetet e caktuara, po ashtu edhe granti i administratës së përgjithshme. Pastaj tha se gjatë planifikimit të buxhetit për vitin 2013, përvèç grantit specifik, i cili ka qenë për arsim dhe shëndetësi, i kemi ndihmuar arsimt me një pjesë që na ka lejuar limiti i pagave. Sa i përket fondit të bashkëfinancimit, tha se nuk janë planifikuar as më shumë e as më pak, por këto planifikime janë në përputhje me vlerën e vendimit të KK-së. Kurse lidhur me zbritjen e mjeteve nga Drejtoria për Arsim, tha se nuk ka zbritje të mjeteve, por ka plotësim të mjeteve në Drejtorenë për Arsim, ndërsa zbritja e mjeteve në administratë ka ndodhur për shkak se, sa mund t'i ndihmohet grantit specifik të shëndetësisë, aq mund edhe të merren. Ndërsa lidhur me çështjen e rrugëve, tha se për rrugët që kanë qenë të planifikuara me buxhet të vitit 2013, janë kryer të gjitha procedurat e prokurimit, mirëpo gjatë konkurrimit kanë mbetur mjete të lira prej secilit projekt dhe mjetet e lira janë paraparë për ridestinim. Në fund tha se Drejtoria për Buxhet dhe Financa është vetëm hartuese e propozim-vendimit, kurse vendimet i merr kuvendi i komunës.

Bajram Mulaku, kryetar i komunës- lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2013, tha se bëhet fjalë për 250.000 €, për të cilat duhet bërë rishikimin e tyre. Pastaj duke folur për renovimin dhe ndërtimin e shkollave, tha se shkolla në fshatin Maxhunaj nuk mund të rinovohet, sepse ajo shkollë duhet të rrënohet për t'u ndërtuar shkolla e re dhe shtoi se ajo shkollë me rishikimin e buxhetit nuk mund të kryhet, kurse shkolla e Pestovës është shpallur si projekt dyvjeçar. Po ashtu për t'i shërbyer një transparence të plotë, kërkoi që në mbledhjen e radhës së KK-së t'ju prezantohet anëtarëve të KK-së lista e veçantë se për cilat projekte do të procedohet dhe e njëjtë

gjë të veprohet edhe për furnizimin e fshatrave me gypa, si dhe për ndriçimet publike. Në vazhdim paraqiti sqarime shtesë lidhur me rishikimin e buxhetit për vitin 2013.

Refik Ramaj, anëtar i kuvendit- në emër të Grupit kuvendar të LDK-së propozoi që të ndahen 5.000 € për shëndetësi, kurse një pjesë e mjeteve të ndahen për rregullimin e urës në rrugën për te varrezat e qytetit.

Sabit Kadriu, anëtar i kuvendit- duke iu referuar rishikimit të buxhetit për vitin 2013, kërkoi që herët tjera, drejtorët e drejtorive komunale të bëjnë planifikim më të mirë.

Në fund të diskutimit lidhur me këtë pikë të rendit të ditës, Kuvendi pas votimit në mënyrë unanime vendosi me sa vijon:

Me këtë vendim bëhet rishikimi i mjeteve të buxhetit të Komunës së Vushtrrisë për vitin 2013, në bazë të Ligjit të Buxhetit për vitin 2013 të MEF-it, dhe kërkesave të programeve buxhetore të komunës.


Mbledhja përfundoi në orën 16:20.

Procesmbajtësi



Albanez Tahiraj

Kryesuesi i Kuvendit



Habib Mustafa

